



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
PREFEKTI I QARKUT ELBASAN
SEKTORI FINANCIAR DHE SHËRBIMET MBËSHTETËSE

Nr. 050/1 Prot

Elbasan, më 12.05.2023

Lënda: Konfirmim akti

KËSHILLIT TË BASHKISË PEQIN

Në zbatim të nenit 16 të ligjit nr.107/2016 "Për Prefektin e Qarkut", pasi u kontrollua ligjshmëria e aktit tuaj nr.29, datë 31.05.2023 "Miratimin e Programit Buxhetor Afatmesëm 2024-2026", konfirmoj në parim mbështetjen e tij në ligj.


PREFEKTI
Majlinda PERRIU



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA PEQIN
DREJTORIA E FINANCES

Nr. 29 .Prot.

Peqin , më 06 .06.2023

VENDIM

NR 29 DATË 31.05.2023
Per

Miratimin e Programit Buxhetor Afatmesem 2024 - 2026

Në mbështetje të Ligjit nr. 139/2015, per “Veteqeverisjen Vendore “, ligjit nr. 9936, datë 26.06.2008, “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë“, i ndryshuar, si dhe në ligjin nr. 68 datë 27.04.2017 “Për Financat e veteqeverisjes vendore“ si dhe udhezimit nr. 8 date 28/02/2022 “Per pregatitjen e Programit Buxhetor afatmesem”Këshilli i Bashkisë me propozim të Kryetarit të Bashkisë

V E N D O S I

1. Te miratoje Programin Buxhetor Afatmesem 2024 – 2026 per Bashkine dhe institucionet e saj vartese sipas tabelave bashkangjitur.
2. Per zbatimin e ketij vendimi ngarkohet Kryetari i Bashkise dhe Drejtorja e Finances

SEKRETAR I KËSHILLIT
LULZIM RESULI



KRYETAR I KËSHILLIT
FLUTURA NUKA

**RELACIONI I PROGRAMIT BUXHETOR
AFATMESEM VENDOR 2024 - 2026
BASHKIA PEQIN**

Programi Buxhetor Afatmesem Vendor 2024 - 2026

Bashkia Peqin

Permbajtja:

1. HYRJE	3
1.1 Roli dhe Qëllimi i Programit Buxhetor Afatmesëm, si një Instrument Efektiv Planifikimi në Nivel Vendor	3
1.2 Fazat e Përgatitjes dhe Miratimit të PBA-së	4
2.Veshtrim I pergjithshem	5
2.1 Situata e njesise e vetqeverisjes vendore	5
2.2 Qellimi	6
2.3 Synimet kryesore te Bashkise	6
3. Plani I te ardhurave per vitin 2024 per bashkine Peqin dhe per PBA 2024-2026	6
4. (E1) Shpenzimet e programeve sipas klasifikimit ekonomik 2024-2026	13
5. Detyrime te prapambetura	29

1. HYRJE

1.1 Roli dhe Qëllimi i Programit Buxhetor Afatmesëm, si një Instrument Efektiv Planifikimi në Nivel Vendor

Programi Buxhetor Afatmesëm (PBA) është një instrument për prezantimin në mënyrë të integruar e disavjeçare të parashikimit të të ardhurave dhe burimeve financiare publike dhe për planifikimin, manaxhimin dhe lëvrimin e shërbimeve publike. Aspekti strategjik i këtyre dokumenteve i jep formë kërkesave për shpenzime për investime publike si dhe për ofrimin e shërbimeve gjatë periudhave disavjeçare. Njësitë e Vetëqeverisjes Vendore (NJVQV-të) janë përgjegjëse për menaxhimin e fondeve publike. Kjo përfshin mbledhjen e taksave dhe tarifave vendore dhe menaxhimin e burimeve kombëtare që transferohen në bashki nga qeveria qendrore, disa prej të cilave kushtëzohen për shërbime specifike. Kjo do të thotë se kërkohet një instrument për të projektuar burimet e përgjithshme të disponueshme për shpenzimet vendore, duke përfshirë këtu: grantet, huatë, taksa e tarifat vendore dhe transferime nga qeveria qendrore (të kushtëzuara dhe të pakushtëzuara). Njësitë e vetëqeverisjes vendore ofrojnë shërbime publike vendore bazuar në kompetencat që u jep ligji. Si rrjedhojë, kjo kërkon një instrument për të lehtësuar dhe menaxhuar mënyrën e përdorimit të burimeve gjithsej, duke përfshirë vendimet për llojin e shpenzimeve (pagat dhe sigurimet; mallrat dhe shërbimet, interesat e borxhit, ripagimi i huave dhe kështu me radhë), si dhe vendimet strategjike se si do të alokohen burime midis llojeve të ndryshme të shërbimeve publike (sigurisë publike, arsimit, shëndetësisë, punëve publike dhe kështu me radhë).

Procesi i PBA-së, prezanton në mënyrë të integruar informacionin mbi parashikimet e të ardhurave dhe burimeve gjithsej dhe përcakton objektivat përse do të shpenzohen ato, kostot e nevojshme dhe llojin e secilit shërbim që do të ofrohet. Ndër të tjera, kjo përfshin lidhjen e qëllimeve dhe objektivave të bashkisë me qëllime strategjike të përcaktuara në strategjitë lokale dhe kombëtare. PBA synon të garantojë që shërbimet publike vendore plotësojnë nevojat në rritje të banorëve duke treguar se si shpenzimet publike për prioritetet strategjike të zhvillimit të njësisë vendore përkthehen në vendime konkrete për ofrimin e shërbimeve publike vendore, me lidhje të qarta mes politikave vendore dhe prioriteteve vjetore të shpenzimeve. Në procesin e PBA-së planifikimi dhe buxhetimi vendor afatgjatë e ndihmon njësinë vendore të planifikojë sesi shërbimet publike do të evoluojnë me kalimin e kohës, duke përcaktuar kërkesat disavjeçare të shpenzimeve në fusha të ndryshme të ofrimit të shërbimeve në përputhje jo vetëm me ndryshimet e parashikuara në demografinë, por edhe në përputhje me ndryshimin e nevojave të banorëve të bashkisë.

Programi Buxhetor Afatmesëm përfshin këto procese:

- prezanton informacionin mbi të ardhurat dhe burimet e disponueshme të bashkisë;
- përkthen vizionin strategjik të NJVQV-së në plane praktike për ofrimin e shërbimeve gjatë një periudhë disavjeçare;
- shpërndan burimet sipas fushave të veçanta të ofrimit të shërbimeve publike,
- përcakton treguesit e performancës në secilën fushë të ofrimit të shërbimeve;

- llogarit kërkesat vjetore të shpenzimeve (korente dhe për investime) në përputhje me objektivat dhe treguesit e performancës për një periudhë disavjeçare;
- përcakton treguesit vjetorë të performancës në përputhje me parashikimet për burimet në dispozicion përgjatë një periudhe disavjeçare.

Në qendër të PBA-së janë dy procese planifikimi dhe buxhetimi që NJVQV-të ndërmarrin për të planifikuar treguesit e performancës dhe shpenzimet afatmesme, si dhe propozimet për buxhetet vjetore:

- Përcaktimi i Qëllimeve dhe Objektivave të Programit (nëpërmjet Rishikimit të Politikës së Programit);
- Planifikimi i Shpenzimeve të Programit (në funksion të ofrimit të shërbimeve).

1.2 Fazat e Përgatitjes dhe Miratimit të PBA-së

Udhëzimi Standart i PBA-së, përcakton kërkesat kryesore të procesit të PBA-së për NJVQV, si dhe kërkesat përkatëse për raportim brenda bashkisë apo tek qeveria qendrore. Aspektet kryesore të udhëzimit standart përfshijnë:

- Rolet dhe përgjegjësitë në procesin e përgatitjes së PBA-së për Kryetarin e NJVV-së, Këshillin e NJVQV, GMS, Zyrtarët Autorizues dhe Ekzekutues, Drejtuesit dhe anëtarët e EMP-ve, si dhe MFE-së;
- Procedurat, fazat e ndryshme, kalendarin dhe metodologjinë për programimin dhe buxhetimin e bazuar në performancë në përgatitjen e PBA-së;
- Kërkesat e raportimit të programit buxhetor afatmesëm. Më konkretisht, kërkesat për të përgatitur dhe prezantuar: Misionin e njësisë së vetëqeverisjes vendore dhe strukturën e programeve; Deklaratat e politikës së programeve; Tavanet e njësisë së vetëqeverisjes vendore sipas programeve; Shpenzimet e programeve sipas artikujve; Shpenzimet e programeve sipas produkteve; Projektet me financim të brendshëm; Projektet me financim të huaj; Formatet plotësuese të kërkesave buxhetore; Projektplanin e arkës, i cili dorëzohet në përfundim të fazës së dytë të përgatitjes së kërkesave buxhetore; Raportet e kërkesave shtesë (Kërkesat shtesë sipas produkteve; Kërkesat shtesë sipas artikujve buxhetor)

Faza 1 e procesit të PBA-së, zhvillohet midis Janarit dhe Qershorit. Kjo është faza strategjike kur merren të gjitha vendimet kryesore për financimin e politikave dhe investimeve të reja. Kjo fazë përmbyllet me përgatitjen e projekt dokumentit të PBA-së, i cili përdoret nga NJVV-ja për të realizuar alokimin strategjik burimeve midis programeve me qëllim përgatitjen e planeve afatmesme të shpenzimeve dhe buxhetit vjetor gjatë fazës teknike të përgatitjes së këtij dokumenti. Në fund të kësaj faze, dokumenti i PBA-së bëhet publik në faqen e internetit të NJVQV-ve për qëllime konsultimi, si dhe dërgohet në MFE, brenda datës 1 qershor e cila përgatit komente dhe rekomandime.

Faza 2 e procesit të PBA-së, zhvillohet midis Korrikut dhe Shtatorit. Kjo është faza teknike gjatë së cilës ekipet e menaxhimit të programeve të njësisë vendore marrin vendimet përfundimtare mbi planet për ofrimin e shërbimeve publike gjatë tre viteve të ardhshme. Gjatë kësaj faze përfshihen vendimet mbi përmbajtjen e projekt buxhetit vjetor që do t'i paraqiten GMS të NJVQV-së. Në përfundim të kësaj faze, përgatitet një version i rishikuar i dokumentit të PBA-së, i cili përdoret nga NJVQV për të vendosur mbi detajet në lidhje me shërbimet publike që do ofrohen si dhe alokimin e shpenzimeve që do të bëhen pjesë e Buxhetit Vjetor. Dokumenti i Rishikuar i PBA-së bëhet publik në faqen e internetit të NJVQV-ve për qëllime konsultimi. Për periudhën nga tetori deri në muajin dhjetor njvqv-ja, merret me finalizimin e dokumentit të PBA-së, si dhe miratimin e Buxhetit Vjetor.

2. Vështrim I përgjithshëm

2.1 Situatat e njësisë e vetqeverisjes vendore

Bashkia Peqin është pjesë e qarkut të Elbasanit , dhe shtrihet në pjesën qendrore të Shqipërisë , nga pikpamja administrative kufizohet me qytetet si: në veri me Tiranën , veri perëndim Rogozhinën , jug perëndim Lushnje , jug Belsh , jug lindje Cerrik dhe lindje dhe veri lindje me Elbasanin.

Sipërfaqja e territorit të Bashkisë Peqin është 193.53 km² , qyteti 1.77 km² dhe njësitë administrative 191.76 km² . Me një popullsi prej 40 179 banorë , ku 10 103 banorë janë në qytet dhe 30 076 janë në njësitë administrative. Pas reformës administrative territoriale Bashkisë i'u bashkuan gjithashtu dhe 5 (pesë) Njese Administrative , konkretisht si më poshtë me numrin e fshatrave përkatës:

Njësia Administrative Gjocaj- 9 (nëntë) fshatra

Njësia Administrative Përparim- 14 (katermbëdhjetë) fshatra

Njësia Administrative Pajovë- 12 (dymbëdhjetë) fshatra

Njësia Administrative Shezë- 7 (shtatë) fshatra

Njësia Administrative Karinë- 7 (shtatë) fshatra

Sipërfaqja në km² e bashkisë përbehet si poshtë:

Zonë urbane : 116.42 km²

Tokë bujqësore : 70.70 km²

Kullota : 2.88 km²

Pyje : 3.53 km²

Projekt buxheti 2024 – 2026 vendor bazohet në qëllimin , synimet dhe objektivat të Bashkisë në veprimtari konkrete për zbatimin e tyre . Përmendim qëllimin dhe synimet duke lënë të kuptohet se mbi baza është projektuar projekt buxheti 2024-2026.

2.2 Qëllimi:

Qëllimi kryesor i Bashkisë është :”Të bashkohemi e të punojmë të gjithë të bashkuar për një qëllim të përbashkët ,për një Peqin të zhvilluar “

Bashkia Peqin është një institucion ambicioz I një qeverisje vendore bashkpunuese dhe me vullnet të mirë që bën përpjekje dhe jep shembullin e maksimizimit për përfitueshmeri dhe zgjidhje të sfidave e projekteve të zhvillimit për Bashkinë dhe komunitetin.

2.3 Synimet kryesore të Bashkisë janë:

Të shëndërrojme bashkinë në qendër të zgjidhjes së problemeve sociale dhe të ndihmës për çdo qytetar

Të shkurtohen diferencat në zhvillim , shërbime e infrastrukture midis zonave më të largëta e më të varfëra të bashkisë dhe qendrës së saj.

Bashkia të shndërrohet në një njesi bazë të zhvillimit ekonomike të vendit , duke nxitur zhvillimin e sektoreve ekonomike sipas karakteristikave të zonës së Peqinit .

Të shkurtojmë distancat dhe rrisim aksesin në Punë ,Arsim dhe Shërbim të familjes peqinase në çdo njesi administrative .

Të perfshijmë të rinjtë e sotëm dhe të pregatisim rinine e së ardhmes , për të drejtuar dhe zhvilluar bashkinë e re si një njesi bazë të integritimit në Europë.

3. Plani I të ardhurave për vitin 2024 për bashkinë Peqin dhe për PBA 2024-2026

Planifikimi i të ardhurave nga taksat dhe tarifat vendore për buxhetin e vitit 2024 dhe PBA 2024-2026, është hartuar sipas metodologjise bazë të proceseve të planifikimit buxhetor, në referencë të plotë të legjislacionit në fuqi dhe Paketës fiskale 2023 në fuqi. Ai vjen në këtë dokument të plotë i ndërtuar sipas kalendarit buxhetor, në përmbushje të plotë të udhëzimeve përkatëse të Ministrisë së Financave për procesin e buxhetimit si dhe Vendimeve Këshillit Bashkiak të marra gjatë vitit aktual buxhetor.

Domosdoshmërisht është mbështetur në një proces gjithë vjetor, të mirë organizuar dhe bën pjesë të tij sygjerimet dhe refleksionet e dala nga analiza e plotë faktoriale e treguesve të realizuar në vite dhe treguesve të pritshëm të vitit financiar që po mbyllet. Struktura e këtij dokumenti i përgjigjet në formë dhe në përmbajtje kërkesës dhe ambicjes sonë profesionale për të ndërtuar një buxhet të balancuar, që i përgjigjet domosdoshmërisht kërkesave për më shumë shërbime të shtuara, më shumë investime, në shërbim të përmirësimit të cilësisë së jetës. Dhe më e rëndësishmja, rritjes së të ardhurave edhe si rezultat i ndërgjegjësimit të kontribuesve duke i

konsideruar si detyrim dhe jo si rëndesë e barrë në jetën e tyre ekonomike. Dinamika e tyre në vite, nëpërmjet analizës së plotë faktoriale është parë si një bazë mbështetëse në kalkulimin e detyrës së planifikuar sikurse dhe përditësimi i bazës së të dhënave dhe projektioni i numrit të kontribuesve, janë pika ku ne kemi lexuar mundësitë dhe kapacitetet për vitin në vijim dhe në planin afatmesëm.

Përcaktimi i niveleve të të ardhurave në total dhe në tregues analitik vjen nga njësia bazë ku dhe gjenerohen, në drejtorinë respektive dhe më tej në planin total. Është dhe për këtë arsye pse ne themi se planifikimi është proces dhe përgjegjesi në çdo qelizë ku dhe implementohet. Referuar hapave të ndjekura konkludojmë se kur krahasojmë dinamikën e të ardhurave me objektivat e vendosura ne njohim:

- Nivelin e treguesve të arritur
- Ndryshimet ligjore në se ka të tilla
- Analizojmë dhe detajojmë faktoreët ndikues në seicilin tregues
- Përcaktojmë analitikisht dhe me ambicje faktorët negativ që kanë ndikuar

Dhe sa më sipër përcaktojmë objektiva mbështetur në kapacitetet jo në funksion të lehtësimit të ngarkesës, por në atë çka ne besojmë se arrijmë edhe pse dukshëm në disa zëra janë më të larta se nivelet e arritura. Për gjatë gjithë periudhës, ne studiojmë mundësi të reja që gjenerojnë të ardhura në zëra të rinj pasi i kushtojmë vëmendjen e duhur gjithë burimeve të mundshme që gjenerojnë të ardhura.

Me poshte eshte tabela me burimin e te ardhurave ne 000 leke per vitet 2024-2026 per bashkine Peqin :


	<i>Burimi I të ardhurave</i>	<i>Parashikimi për vitin 2023</i>	<i>Parashikimi për vitin 2024</i>	<i>Parashikimi për vitin 2025</i>	<i>Parashikimi për vitin 2026</i>
A	TE ARDHURA NGA BURIMET E VETA	173 167	174 096	174 220	174 368
<i>A.1</i>	<i>Te ardhura nga taksa lokale</i>	<i>91 100</i>	<i>91 100</i>	<i>91 100</i>	<i>91 100</i>
A 1.1	Te ardhura vendore mbi biznesin e vogel	3 000	3 000	3 000	3 000
A 1.2	Takse mbi pasurine e paluajshme	50 000	50 000	50 000	50 000
A 1.3	Takse e ndikimit ne infrastrukture nga ndertimet e reja	38 000	38 000	38 000	38 000

A 1.4	Takse tabele	100	100	100	100
A.2	<i>Te ardhura nga taksat e ndara (grante)</i>	18 500	18 929	18 788	20 101
A.2.1	Taksa mbi kalimin e te drejtes se pronesise / pasurite e paluajtshme	1 000	1 000	1 000	1 000
A 2.2	Takse vendore per qarkullimin e mjeteve te perdorura	11 000	11 000	11 000	11 000
A 2.3	Takse e rentes minerare	500	500	500	500
A 2.4	Takse mbi te ardhurat personale	6 000	6 429	6 288	7 601
A.3	<i>Te ardhura nga tarifa vendore</i>	58 267	58 767	59 032	57 867
A.3.1	Tarifa e menaxhimit te mbtjeve	37 800	37 800	37 800	37 800
A 3.2	Tarifa per ndricimin publik	5 000	5 000	5 000	5 000
A 3.3	Tarife per gjelberimin	1 185	1 185	1 185	1 185
A 3.4	Tarife per sherbimet administrative te bashkise	13 200	13 700	13 965	12 800
A 3.5	Tarifa te tjera	1 082	1 082	1 082	1 082
A.4	<i>Te ardhurat e tjera</i>	5 300	5 300	5 300	5 300
A 4.1	Qera nga asetet ne pronesi te bashkise	5 000	5 000	5 000	5 000
A 4.2	Sekuestri dhe zhdemtime	200	200	200	200
A 4.3	Te tjera	100	100	100	100
B	TE ARDHURA NGA BUXHETI QENDROR	256 884	265 844	276 048	288 297

B.1	Transferta e pakushtezuar	161 373	170 333	180 537	192 786
B.2	Transferta e pakushtezuar sektoriale	95 511	95 511	95 511	95 511
C	TRASHEGIMI NGA VITI I SHKUAR	12 050			
TOTALI I TE ARDHURAVE	(A+B+C)	442 101	439 940	450 268	462 665


A.1 Të ardhura nga taksat lokale

Zërat që zenë më shumë rëndësi në këtë të ardhur janë : Taksa mbi pasurine paluajtshme , takes e ndikimit në infrastrukture nga nërtimet e reja , taksë vendore mbi biznesin dhe me pak taksa tabele , si në grafikun më poshtë të shprehura ne 000 leke .




A.2 Të ardhura nga taksat e ndara (grante)

Zërat që zenë më shumë rëndësi në këtë të ardhur janë : taksa vendore për qarkullimine mjeteve të përdorura , taksa mbi të ardhurat personale dhe me më pak janë takse mbi kalimin e të drejtës së pronesisë dhe taksë e rentës minerare , si në grafikun më poshtë të shprehura në 000 lekë .




A.3 Të ardhura nga tarifat vendore

Zërat që zenë më shumë rëndësi në këtë të ardhur janë: tarifa për menaxhimin e mbetjeve , tarifa për shërbimet administrative të bashkisë dhe më pak tarife per ndricimin publik, tarifë gjelbërimi , dhe tarifa të tjera, si në grafikun më poshtë të shprehura në 000 lekë .




A.4 Të ardhura të tjera

Zëri që zë më shumë rëndësi në këtë të ardhur është qeraja nga asetet në pronësi të bashkisë dhe më pak sekuestrime dhe zhdimime dhe të tjera , si në grafikun më poshtë të shprehura në 000 lekë .



B . Të ardhur nga buxheti qendror

Ky zë përbëhet nga transfertat e pakushtëzuar dhe transfertat e pakushtëzuar sektoriale , ato kanë një ndikim në buxhetin e bashkisë për vitin 2023 dhe vitet 2024 – 2026 janë të paraqitura në grafikun më poshtë në 000 leke .




D.Trashëgimi nga viti i shkuar

Ky zë zen një përqindje të vogël në buxhetin e bashkisë , këto të ardhura trashëgohen zakonisht nga transfertat e pakushtëzuar sektoriale .


Të ardhurat e buxhetit të bashkisë të shprehura në përqindje janë si më poshtë :

2023




- Te ardhura nga burimet e veta
- Te ardhura nga buxheti qendror
- Trashgimni nga viti shkuar

2024




- Te ardhura nga burimet e veta
- Te ardhura nga buxheti qendror

2025



- Te ardhura nga burimet e veta
- Te ardhura nga buxheti qendror

2026



- Te ardhura nga burimet e veta
- Te ardhura nga buxheti qendror

4. (E1) Shpenzimet e programeve sipas klasifikimit ekonomik 2024-2026

Tabela e mëposhtme paraqet shpenzimet aktuale, të buxhetuara dhe të planifikuara të Bashkisë mbi baza vjetore për secilën kategori ekonomike të shpenzimeve gjatë periudhës 2021 deri në 2026.

000 leke

SHPENZIMET KAPITALE SIPAS PROGRAMEVE		2021	2022	2023	2024	2025	2026
01110	Planifikimi Menaxhimit dhe Administrimit	97 299	86 079	99 315	101 000	105 000	107 000
03140	Sherbimet e Policisë Vendore	5 080	5 517	6 093	6 100	6 100	6 100
03280	Mbrojtja nga zjarri dhe mbrojtja civile	17 221	18 703	20 986	22 200	22 200	22 200
04220	Sherbimet bujqesore , inspektimi , ushqimi dhe mbrojtja e konsumatoreve	7 704	8 856	10 620	11 230	11 230	11 230
04240	Menaxhimi infrastrukturës së ujitjes dhe kullimit	4 912	4 145	12 795	12 795	12 795	12 795
04260	Administrimi i pyjeve dhe kullotave	4 091	5 403	6 631	6 850	6 850	6 850
04520	Rrjeti rrugor rural	15 694	30 791	47 614	56 105	57 309	65 558
05100	Menaxhimi i mbetjeve	37 826	35 239	74 900	70 200	70 200	70 200
06140	Planifikimi Urban Vendor	6 977	7 416	10 175	9 680	9 680	9 680
06260	Shërbime publike vendore	17 349	26 503	36 213	28 780	33 780	33 780
08130	Sport dhe argëtim	4 441	8 829	10 534	12 730	12 730	12 730
08220	Trashëgimia kulturore , evente artistike,dhe kulturore	6 818	7 553	8 480	9 500	9 500	9 500
09120	Arsimi bazë perfshire arsimin parashkollor	43 499	51 705	61 917	65 200	65 200	67 200
09230	Arsimi i mesem i përgjithshëm	3 872	4 247	10 686	6 600	4 600	4 600
10430	Kujdesi social per familjet dhe femijet	11 079	13 245	18 740	17 690	17 690	17 690
	Totali	283 862	314 231	435 699	434 660	444 864	457 113

Plani i shpenzimeve sipas ndarjes ekonomike per vitin 2024

Plani i shpenzimeve të vitit 2024 prej 434 660 mijë lekë sipas ndarjes ekonomike :

Shpenzime për paga & sigurime (art. 600+601) janë planifikuar në shumën 236 009 mijë lekë, për 336 punonjës. Në krahasim me planin e vitit 2023 janë planifikuar me ulje në shumën 236 934 mijë lekë , kjo ulje vjen si pasojë se ne vitin 2023 parashikohet që të likuidohen disa paga te punonjësve të prapambetura që bashkia ka . Shpenzimet e personelit zënë 54.3 % të buxhetit total të vitit 2024.

Shpenzime operative për mallra dhe shërbime(art. 602) janë planifikuar në shumën 148 171 mijë lekë. Në krahasim me vitin 2023 janë planifikuar me ulje në vleren 1 504 mijë lekë ,ulja vjen si pasojë e disa detyrimeve që bashkia ka dhe do ti likuidojë brenda vitit 2023.

Shpenzimet operative për mallra dhe shërbime zënë 34 % të buxhetit total të vitit 2024.

Transfertat për buxhete familjare dhe individë (art. 606) janë planifikuar në shumën 11 420 mije lekë ne vitin 2024. Në këtë zë përfshihen Fondi rezervë,fondi i kontingjencës, fondi i emergjencës dhe i mbrojtjes civile.

Transfertat për buxhete familjare dhe individë zënë 2.7 % të buxhetit total të vitit 2024.

Shpenzime kapitale (art. 230&231) janë planifikuar në shumën 39 060 mijë lekë. Në krahasim me vitin 2023 janë planifikuar pothuajse në të njëjtin nivel.

Shpenzimet kapitale zënë 9 % të buxhetit total të vitit 2024.

Plani i shpenzimeve sipas ndarjes ekonomike per vitin 2025

Plani i shpenzimeve të vitit 2025 prej 444 864 mijë lekë sipas ndarjes ekonomike :

Shpenzime për paga & sigurime (art. 600+601) janë planifikuar në shumën 236 009 mijë lekë, për 336 punonjës. Në krahasim me planin e vitit 2024 janë planifikuar në të njëjtën vlere .

Shpenzimet e personelit zënë 53 % të buxhetit total të vitit 2025.

Shpenzime operative për mallra dhe shërbime(art. 602) janë planifikuar në shumën 152 171 mijë lekë. Në krahasim me vitin 2024 janë planifikuar me rritje në vleren 4 000 mijë lekë.

Shpenzimet operative për mallra dhe shërbime zënë 34,2 % të buxhetit total të vitit 2025.

Transfertat për buxhete familjare dhe individë (art. 606) janë planifikuar në shumën 11 420 mijë lekë në vitin 2025. Në këtë zë përfshihen Fondi rezervë,fondi i kontingjencës, fondi i emergjencës dhe i mbrojtjes civile.

Transfertat për buxhete familjare dhe individë zënë 2.6 % të buxhetit total të vitit 2025.

Shpenzime kapitale (art. 230&231) janë planifikuar në shumën 45 264 mijë lekë. Në krahasim me vitin 2024 janë më shume për shkak të angazhimeve që bashkia programon të marrë.

Shpenzimet kapitale zënë 10.2 % të buxhetit total të vitit 2025.

Plani i shpenzimeve sipas ndarjes ekonomike për vitin 2026

Plani i shpenzimeve të vitit 2026 prej 457 113 mijë lekë sipas ndarjes ekonomike :

Shpenzime për paga & sigurime (art. 600+601) janë planifikuar në shumën 236 009 mijë lekë, për 336 punonjës. Në krahasim me planin e vitit 2025 janë planifikuar në të njëjtën vlerë .
Shpenzimet e personelit zënë 51.5 % të buxhetit total të vitit 2025.

Shpenzime operative për mallra dhe shërbime(art. 602) janë planifikuar në shumën 152 171 mijë lekë. Në krahasim me vitin 2025 janë planifikuar po në të njëjtën vlerë.
Shpenzimet operative për mallra dhe shërbime zënë 33.2 % të buxhetit total të vitit 2026.

Transfertat për buxhete familjare dhe individë (art. 606) janë planifikuar në shumën 11 420 mijë lekë ne vitin 2026. Në këtë zë përfshihen Fondi rezervë, fondi i kontingjencës, fondi i emergjencës dhe i mbrojtjes civile.
Transfertat për buxhete familjare dhe individë zënë 2.5 % të buxhetit total të vitit 2026.

Shpenzime kapitale (art. 230&231) janë planifikuar në shumën 57 513 mijë lekë. Në krahasim me vitin 2025 janë me shumë për shkak të angazhimeve që bashkia programon të marrë.
Shpenzimet kapitale zënë 12.8 % të buxhetit total të vitit 2026

Programi 01110 ; Planifikimi , menaxhimi dhe planifikimi

Zhvillimi i njësisë, menaxhimi i financave të njësisë së vetëqeverisjes vendore, të burimeve të tjera si dhe të burimeve njerëzore, funksionimi i proceseve të përgjithshme të brendshme dhe komunikimi me publikun. Shërbime në mbështetje të kryetarit të njësisë së vetëqeverisjes vendore ose të këshillit;

Qëllimet dhe Objektivat e Politikës së Programit Ky program parashikon menaxhimin financiar të Bashkisë Peqin dhe përfshin shpenzimet e nevojshme administrative për mbarëvajtjen e punës në përmbushjen e funksioneve të përcaktuara në legjislacion.

Plani i Shpenzimeve të Produkteve të Programit Buxheti i vitit 2024 për programin 01110 Planifikim, menaxhim dhe administrim është planifikuar në shumën 101 000 mijë lekë, dhe zë 23.2 % të buxhetit total.

Në krahasim me vitin 2023 buxheti i vitit 2024 për këtë program është ulur me vlerën 127 mijë lekë ose në masën 0.1 %.

Për vitin 2024:

Shpenzime për paga & sigurime (art. 600+601) janë planifikuar në shumën 72 100 mijë lekë, për 96 punonjës.

Shpenzime operative për mallra dhe shërbime(art. 602) janë planifikuar në shumën 25 200 mijë lekë. Në krahasim me vitin 2023 (plan) janë planifikuar me rritje në shumën 532 mijë lekë ose 2.1 %. Keto shpenzime parashikohen për blerje materiale kancelerike , shpenzime për karburant , shpenzime operative të ndyshme dhe shpenzime për energji elektrike dhe ujësjellës.

Transfertat e brendshme (art. 604) janë planifikuar në shumën 700 mijë lekë.

Shpenzimet kapitale (art.231) janë planifikuar në vlerën 3 000 mijë leke për blerje materiale zyre.

Në vitet 2025-2026 parashikohet një rritje prej 400 mijë lekë dhe kjo rritje parashikohet të zeri mallra dhe shërbime për nevojat e personelit dhe për efektivitetin e programit.

(000 leke)

Emertimi llogarise	2023	2024	2025	2026
Paga & sigurime (600, 601)	72 227	72 100	72 100	72 100
Shpenzime korrente te tjera	26 588	25 900	29 900	29 900
Shpenzime kapitale	500	3 000	3 000	3 000
Shuma:	99 315	101 000	105 000	107 000

Programi 03140 ; Shërbimet e policisë vendore

Administrimi i çështjeve dhe shërbimeve policore që janë të nevojshme për kryerjen e funksioneve në shërbim të rendit, qetësisë dhe mbarëvajtjes së punëve publike, parandalimin dhe zbulimin e informalitetit brenda territorit të njësisë së vetëqeverisjes vendore.

Plani i Shpenzimeve për Buxhetin e vitit 2024 për programin 03140 shërbimet e policies vendore është planifikuar në shumën 6 100 mijë lekë, dhe zë 1.4 % të buxhetit total.

Për vitin 2024:

Shpenzime për paga & sigurime (art. 600+601) janë planifikuar në shumën 5 500 mijë lekë, për 9 punonjës.

Shpenzime operative për mallra dhe shërbime(art. 602) janë planifikuar në shumën 300 mijë lekë. Këto fonde parashikohen për blerje kancelarike dhe shpenzime për energji elektrike dhe ujësjellës .

Transfertat e brendshme (art. 604) janë planifikuar në shumën 300 mijë lekë.

Në vitet 2025-2026 parashikohet po e njëjta vlere si në tabelen më poshte të shprehur në 000 lekë.

(000 lekë)

Emertimi llogarise	2023	2024	2025	2026
Paga & sigurime (600, 601)	5 893	5 500	5 500	5 500

Shpenzime korrente te tjera	200	600	600	600
Shpenzime kapitale				
Shuma:	6 093	6 100	6 100	6 100

Programi 03280 ; Mbrojtja nga zjarri dhe mbrojtja civile

Garantimi i shërbimit zjarrfikës në nivel vendor dhe administrimi i strukturave përkatëse; Parandalimi, mbrojtja nga zjarri dhe përballimi i emergjencave të tjera që vijnë nga rreziqet natyrore ose aksidentet e trafikut rrugor.

Plani i Shpenzimeve për Buxhetin e vitit 2024 për programin 03280 mbrojtja nga zjarri dhe mbrojtja civile është planifikuar në shumën 22 200 mijë lekë, dhe zë 5.1 % të buxhetit total.

Për vitin 2024:

Shpenzime për paga & sigurime (art. 600+601) janë planifikuar në shumën 19 000 mijë lekë, për 23 punonjës.

Shpenzime operative për mallra dhe shërbime(art. 602) janë planifikuar në shumën 2 700 mijë lekë. Këto fonde parashikohen për blerje karburanti për energji elektrike dhe ujësjellës për blerje për nevojat e kësaj strukture .

Transfertat e brendshme (art. 604) janë planifikuar në shumën 500 mijë lekë.

Në vitet 2025-2026 parashikohet po e njëjta vlere si në tabelën më poshte të shprehur në 000 lekë.

(000 lekë)

Emertimi llogarise	2023	2024	2025	2026
Paga & sigurime (600, 601)	18 532	19 000	19 000	19 000
Shpenzime korrente te tjera	2 454	3 200	3 200	3 200
Shpenzime kapitale				
Shuma:	20 986	22 200	22 200	22 200

Programi 04220 ; Shërbime bujqësore , inspektimi , siguria ushqimore & mbrojtja e konsumatorëve.

Programi mbulon mbështetjen e zhvillimit të qëndrueshëm të prodhimit bujqësor, mbrojtjen e konsumatorëve, menaxhimin e ujitjes dhe kullimit

Plani i Shpenzimeve për Buxhetin e vitit 2024 për programin 04220 Shërbime bujqësore , inspektimi , sigurime ushqimore dhe mbrojtja e konsumatorit është planifikuar në shumën 11 230 mijë lekë, dhe zë 2.5 % të buxhetit total.

Për vitin 2024:

Shpenzime për paga & sigurime (art. 600+601) janë planifikuar në shumën 10 200 mijë lekë, për 16 punonjës.

Shpenzime operative për mallra dhe shërbime(art. 602) janë planifikuar në shumën 1 030 mijë lekë. Këto fonde parashikohen për blerje karburanti për energji elektrike dhe ujësjellës për blerje për nevojat e kësaj strukture .

Transferrat e brendshme (art. 604) janë planifikuar në shumën 400 mijë lekë.

Në vitet 2025-2026 parashikohet po e njëjta vlere si në tabelën më poshte të shprehur në 000 lekë.

(000 lekë)

Emertimi llogarise	2023	2024	2025	2026
Paga & sigurime (600, 601)	9 920	10 200	10 200	10 200
Shpenzime korrente te tjera	700	1 030	1 030	1 030
Shpenzime kapitale				
Shuma:	10 620	11 230	11 230	11 230

Programi 04240 ; Menaxhimi i infrastrukturës së ujitjes dhe kullimit.

Mbështetja e zhvillimit të qëndrueshëm të prodhimit bujqësor, mbrojtja e konsumatorëve, menaxhimi i ujitjes dhe kullimit; Përmirësimi i politikave për ujitjen, kullimin dhe mbrojtjen nga përmbytja në përshtatje me ndryshimet klimaterike.

Plani i Shpenzimeve për Buxhetin e vitit 2024 për programin 04240 Menaxhimi i infrastrukturës së ujitjes dhe kullimi është planifikuar në shumën 12 795 mijë lekë, dhe zë 2.9 % të buxhetit total.

Për vitin 2024:

Shpenzime për paga & sigurime (art. 600+601) janë planifikuar në shumën 1 589 mijë lekë, për 2 punonjës.

Shpenzime operative për mallra dhe shërbime(art. 602) janë planifikuar në shumën 11 206 mijë lekë. Këto fonde parashikohen për blerje karburanti për energji elektrike dhe për blerje për nevojat e kësaj strukture .

Transfertat e brendshme (art. 604) janë planifikuar në shumën 200 mijë lekë.

Në vitet 2025-2026 parashikohet po e njëjta vlerë si në tabelën më poshtë të shprehur në 000 lekë.

(000 lekë)

Emertimi llogarise	2023	2024	2025	2026
Paga & sigurime (600, 601)	1 700	1 589	1 589	1 589
Shpenzime korrente te tjera	11 095	11 206	11 206	11 206
Shpenzime kapitale				
Shuma:	12 795	12 795	12 795	12 795

Programi 04260 ; Administrimi i pyjeve dhe kullotave .

Programi i administrimit të pyjeve përfshin hartimin e politikave për menaxhimin e qëndrueshëm të pyjeve dhe kullotave, zhvillimin e një ekonomie të gjelbër, të praktikave më të mira në fondin pyjor dhe kullosor, eficientë nga pikëpamja ekonomike, miqësore me mjedisin dhe të pranueshme nga shoqëria. Automatizimi i bazës së të dhënave për regjistrin pyjor dhe digjitalizimi i hartave, mbështetjen e kërkimit, zhvillimit teknologjik e inovacioneve në pyje, dhënia e shërbimit këshillimor dhe aftësimin e kapaciteteve të personelit pyjor dhe administrativ lokal, harmonizimi ligjor e nënligjor, bashkëpunimi institucional me struktura të tjera të interesuara për menaxhimin e qëndrueshëm e ruajtjen e biodiversitetit.

Plani i Shpenzimeve për Buxhetin e vitit 2024 për programin 04260 Administrimi i pyjeve dhe kullotave është planifikuar në shumën 6 850 mijë lekë, dhe zë 1.6 % të buxhetit total.

Për vitin 2024:

Shpenzime për paga & sigurime (art. 600+601) janë planifikuar në shumën 6 700 mijë lekë, për 12 punonjës.

Shpenzime operative për mallra dhe shërbime(art. 602) janë planifikuar në shumën 150 mijë lekë. Këto fonde parashikohen për energji elektrike dhe për blerje për nevojat e kësaj strukture .

Në vitet 2025-2026 parashikohet po e njëjta vlerë si në tabelën më poshtë të shprehur në 000 lekë.

(000 lekë)

Emertimi llogarise	2023	2024	2025	2026
Paga & sigurime (600, 601)	6 430	6 700	6 700	6 700
Shpenzime korrente te tjera	201	150	150	150
Shpenzime kapitale				
Shuma:	6 631	6 850	6 850	6 850

Programi 04520 ; Rrjeti rrugor rural .

Ndërtimi, rehabilitimi dhe mirëmbajtja e rrugëve vendore dhe sinjalizimit rrugor brenda juridiksionit të njësisë së vetëqeverisjes vendore.

Plani i Shpenzimeve për Buxhetin e vitit 2024 për programin 04520 Rrjeti rrugor rural është planifikuar në shumën 56 105 mijë lekë, dhe zë 12.9 % të buxhetit total.

Për vitin 2024:

Shpenzime për paga & sigurime (art. 600+601) janë planifikuar në shumën 15 730 mijë lekë, për 31 punonjës.

Shpenzime operative për mallra dhe shërbime(art. 602) janë planifikuar në shumën 9 715 mijë lekë. Këto fonde parashikohen për blerje karburanti dhe për blerje për nevojat e kësaj strukture .

Transfertat e brendshme (art. 604) janë planifikuar në shumën 600 mijë lekë.

Shpenzimet kapitale (art.231) janë planifikuar në vlerën 30 060 mijë lekë për disa angazhime që bashkia ka marrë dhe projektin të marrë si në tabelën më poshtë të shprehura në 000 leke :

(000 lekë)

Kodi projekti	Emertimi projektit	Vlera kontrates	Burimi final	2021 fakti	2022 fakti	2023 buxheti	2024 plani	2025 plani	2026 plani
